



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Në bazë të nenit 11.5 dhe 64.2 (a) dhe (b) të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe Ligjit Nr. 03/L-256 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe nenit 29.1 dhe 20 të Ligjit nr. 03/072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me datë 02. 07. 2013, nxjerr:

RREGULLËN ZGJEDHORE Nr. 05/2013
KUTITË POSTARE DHE KOMUNIKIMI ELEKTRONIK ME SUBJEKTET
POLITIKE

Neni 1

Dispozitat e përgjithshme

Kjo rregull ka për qëllim të rregullojë, dorëzimi i dokumenteve të subjekteve politike në kuti postare të KQZ-së, mënyrën e korrespondencës me subjekte politike.

Neni 2

Përkufizimet

- 2.1 **Komisioni Komunal i Zgjedhjeve (KKZ)** - është organ përgjegjës për zbatimin e aktiviteteve zgjedhore brenda territorit të komunës.
- 2.2 **Personi kontaktues** - do të thotë personi i cili është i autorizuar të komunikojë në emër të subjektit politik me zyrën për çështje jo-financiare.
- 2.3 **Subjekti politik** - do të thotë parti politike, koalicion, nismë qytetare ose kandidat i pavarur.

Neni 3

Kontrollimi i kutisë postare

- 3.1 Secili subjekt politik i certifikuar për të marrë pjesë në zgjedhje, duhet ta kontrollojë rutinë e vet postare së paku dy herë në javë (çdo të martë dhe të premte) prej kohës kur personi kontaktues i subjektit politik e merr çelësin e deri në fillim të periudhës së fushatës.
- 3.2 Prej fillimit të periudhës së fushatës e deri në certifikimin e rezultateve të zgjedhjeve, subjektet politike të certifikuara duhet t'i kontrollojnë kutitë e veta postare, çdo ditë përveç të dielës.
- 3.3 KQZ-ja, mund t'i dorëzojë subjektit politik çfarëdo dokumenti duke shfrytëzuar rutinë postare të subjektit politik. KQZ-ja, do të shënojë kohën në të cilën ata do të vendosin çfarëdo shkresë në rutinë postare të subjektit politik.

Neni 4

Dorëzimi i dokumentit në kuti

- 4.1 Shkresa ose dokumenti që dërgohet në rutinë postare të subjektit politik para periudhës së fushatës do të konsiderohet se është dorëzuar te ai subjekt në orën 16:00, të martën ose të premten pas datës në të cilën letërkëmbimi është vendosur në rutinë postare të atij subjekti.
- 4.2 Shkresa ose dokumenti që dërgohet në rutinë postare të subjektit politik gjatë periudhës së fushatës do të konsiderohet se i është dorëzuar atij subjekti:
 - a) në orën 16:00 në ditën në të cilën korrespondenca është vendosur në rutinë postare të subjektit, nëse ajo është vendosur në rutinë postare të subjektit para orës 10:00 ose
 - b) në orën 16:00 një ditë pas vendosjes së korrespondencës në rutinë postare të subjektit, nëse ajo është vendosur në rutinë postare të subjektit pas orës 10:00.
- 4.3 Gjatë kohës para periudhës së fushatës, Zyra do ta njoftojë paraprakisht personin kontaktues të subjektit politik se korrespondenca (materiali) do të vendoset në rutinë e tij postare. Subjekti politik, të cilit i është dhënë njoftim paraprak për dërgimin e korrespondencës, (materialit, dokumentit), do të konsiderohet se e ka marrë korrespondencën në ditën e vendosjes së dokumentit në rutinë postare.

4.4 Zyra përmes librit të protokollit evidenton çdo shkresë apo dokument të vendosur në kutitë postare për subjektet politike dhe anasjelltas.

Neni 5

Korrespondenca nga subjektet politike

5.1 Me përjashtim të nenit 4.2, subjektet politike mund të dërgojnë korrespondenca zyrtare në KQZ dhe Zyrë përmes kutive të veta postare.

5.2 Subjekti politik duhet t'ia dërgojë Zyrës personalisht këto dokumente:

- a) listat e kandidatëve;
- b) kërkesat për akreditim të vëzhguesve dhe
- c) formularët e publikimit financiar të fushatës.

5.3 KQZ-ja, Zyra i kontrollojnë kutitë e tyre postare dy herë në ditë dhe do të shënojnë datën dhe kohën në të cilën ata marrin çdo korrespondencë nga subjekti politik. Një dokument konsiderohet të jetë i pranuar në kohën e kontrollit paraprak të kutisë postare.

5.4 Me kërkesën e subjektit politik, sigurohet komunikimi përmes kutisë postare.

Neni 6

Korrespondenca elektronike

6.1 Secili subjekt politik i certifikuar për të marrë pjesë në zgjedhje, mund të dorëzojë në adresë zyrtare elektronike të Zyrës, materiale përpos materialeve të cekura në nenin 5.2 të kësaj rregulle.

6.2 Materialet e dorëzuara nga subjektet politike të certifikuara duhet të jenë të nënshkuara nga kryetari i subjektit politik apo personi i autorizuar për kontakte me Zyrën.

6.3 Materialet duhet të skanohen dhe të dorëzohen me postë elektronike sipas afateve të parapara ligjore.

6.4 Zyra konfirmon marrjen e materialeve me postë elektronike dhe bën arkivimin e tyre.

Neni 7

Subjektet politike që kanë selitë jashtë Prishtinës

- 7.1 Zyra e autorizon Zyrtarin Komunal të Zgjedhjeve (më tutje “ZKZ”) si person kontaktues për zgjedhje për secilin subjekt politik të certifikuar që e ka selinë e vet jashtë Prishtinës.
- 7.2 Personi kontaktues për zgjedhje (ZKZ) do të sigurojë korrespondencën nga KQZ-ja dhe Zyra për subjektin politik, dhe nga subjekti politik për KQZ-në dhe Zyrën, sa më parë që të jetë e mundur.
- 7.3 Me përjashtim të neneve 5.2 dhe 6.4 të kësaj rregulle, subjekti politik duhet të dërgojë korrespondencën në KQZ dhe Zyrë përmes personit të tij për kontakt lidhur me zgjedhjet. Një dokument konsiderohet të jetë pranuar nga KQZ-ja apo Zyra në kohën e marrjes nga personi kontaktues për zgjedhje (ZKZ). Zyrtari kontaktues për zgjedhje (ZKZ) duhet t’ia dorëzojë dokumentin pranuar menjëherë KQZ-së apo Zyrës.
- 7.4 Subjektet politike duhet t’i dërgojnë raportet e tyre financiare dhe çdo korrespondencë që lidhet me raportet financiare personalisht në Zyrë.
- 7.5 Personi kontaktues për zgjedhje (ZE i KZ-së) duhet të shënojë kohën në të cilën çdo korrespondencë i është dërguar subjektit politik ose është marrë prej tij.
- 7.6 Secili subjekt politik i certifikuar duhet të dërgojë përfaqësuesin për të marrë korrespondencën nga personi për kontakte të cilin e cakton Zyra (ZKZ) lidhur me zgjedhjet, ose së paku çdo të martë dhe të premte deri në fillim të periudhës së fushatës.
- 7.7 Secili subjekt politik i certifikuar duhet të dërgojë përfaqësuesin për të marrë korrespondencën nga personi për kontakte (ZKZ) lidhur me zgjedhjet, çdo ditë përveç të dielës, që nga fillimi i periudhës së fushatës deri në certifikimin e rezultateve të zgjedhjeve.
- 7.8 Gjatë kohës para periudhës së fushatës, personi kontaktues për zgjedhje (ZKZ) e njofton personin kontaktues të subjektit politik se e ka marrë korrespondencën. Subjekti politik, të cilit i është dhënë njoftimi paraprak për dërgimin e korrespondencës, do të konsiderohet se e ka marrë korrespondencën një ditë pas atij njoftimi.

Neni 8
Dispozitat Kalimtare dhe Përfundimtare

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulle, shfuqizohet Rregulla Zgjedhore numër 05/2008
Kutitë Postare të Subjekteve Politike, e datës 25.06.2009.

Neni 9
Hyrja në fuqi

Kjo rregull hyn në fuqi më datë 02.07.2013.

Kryetari i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve
Valdete Daka

